



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 3133/1 Prot (D.B)

Tiranë, më 07.03.2024

Lënda: Dërgohet informacion.  
Drejtuar : KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE  
Z.Illirjan CELIBASHI

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj, Nr.475/1 Prot. datë 19.02.2024, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në lidhje me çështjet penale në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara në vitin 2023, si edhe për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, ju informojmë se :

- Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, janë regjistruar 37 procedime penale me 12 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me krimet zgjedhore, në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara për vitin 2023.
- Janë dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim 5 procedime penale me 11 persona të pandehur për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

-Në lidhje me vendimet e përfundimit të gjykimit për veprat penale që lidhen me krimet zgjedhore, në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të zhvilluara për vitin 2023, ju mund ti drejtoheni Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

-Përsa i përket të dhënave për gjeneralitetet e personave të regjistruar nën hetim konkretisht tabela e mëposhtme :

Nr. Rend	Gjinia	Viti i lindjes	Arsimi	Gjendja Gjyqësore	Gjendja Shoqërore
1	Mashkull	1984	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna
2	Mashkull	1971	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna
3	Mashkull	1962	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna
4	Mashkull	1972	I lartë	I padënuar	Nëpunës i nivelit të lartë
5	Mashkull	1979	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna
6	Mashkull	1992	I lartë	I padënuar	Nëpunës i nivelit të mesëm
7	Mashkull	1979	I mesëm	I padënuar	Nëpunës i thjeshtë

8	Mashkull	1960	I mesëm	I padënuar	Nëpunës niveli ekzekutues
9	Mashkull	1990	I lartë	I padënuar	Nëpunës i thjeshtë
10	Mashkull	1975	I mesëm	I dënuar	Ska të dhëna
11	Mashkull	1982	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna
12	Mashkull	1953	I mesëm	I padënuar	Ska të dhëna

-Në lidhje me zgjedhjet e pjesshme të mbajtura me 24 shtator 2023, për Kryetar të Bashkisë Kukës, nuk rezulton që të kemi ndonjë procedim penal apo person nën hetim të regjistruar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**DREJTUESI I PROKURORISË  
ALTIN DUMANI**

